



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:173676  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05518104

Ac.nr.7997/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Feka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. H. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Enver Ajvazi, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimi (DKA), të cilën me autorizim e përfaqëson zyrtari i Lartë Ligjor pranë Komunës së Gjilanit, Burim Maliqi, për kompensimin e shujtës ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1005/2021, të datës 18.10.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 28.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimi (DKA), NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1005/2021, të datës 18.10.2023 në pikën I (një) të dispozitivit, në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë së paditëses K. H. përkritazi me kompensimin e shpërblimit jubilar, ashtu që për këtë pjesë gjykohet si në vijim: REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses K. H., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimi që paditëses, në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite përvojë pune t'ia kompensojë në vlerë të 50 % të një page bazë, shumën prej 134,00 €.

II. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale e Arsimi (DKA), ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1005/2021, i datës 18.10.2023, në pikën I (një) të dispozitivit me të cilën është detyruar e paditura Komuna e Gjilanit, Drejtoria Komunale për Arsim që paditëses K. H. në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë, t'ia paguajë shumën monetare në lartësi prej 1,418,00 € për 709 ditë pune, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri më 30.04.2020, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, ën afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën pasojat e përmbarimit ligjor, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C C.nr.1005/2021, i datës 18.10.2023, ka vendosur si në vijim: I. MIRATOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K. H. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të emër të shpërblim të pagës jubilar, për 10 vite përvojë pune, në vlerë të 50% të një page bazë, t'ia paguajë shumën monetare prej 134€, si dhe në emër të ushqimit ditor për ditët e pranisë në punë, t'ia paguajë shumën monetare në lartësi prej 1,418.00€, (për 709 ditë), për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më 30.04.2020, respektivisht shumën e përgjithshme monetare prej 1,552.00€, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor. II. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 134.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe çështjen t'ia kthejë të njëjtës gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje apo ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëses.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjenet se paditësja të ketë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja K. H. nga Gjilani, përmes të autorizuarit të saj, me datë 03.08.2021, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për kompensimin e shujtës ditore, kundër të paditurës, me pretendimet se e njëjta është e punësuar tek e paditura, përkatësisht në SHFMU "S. H." në Gjilan si punëtoresh teknike dhe se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit, paditëses i takon kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë (më detajisht si në padi në shkresa të lëndës). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1005/2023, të datës 18.10.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se “ gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje kontestuese i ka administruar këto prova materiale: Vërtetimi me nr. të prot.ë186/2021 i datës 11.06.2021 i lëshuar nga SHFMU “S. H.” në Gjilani përmes së cilës vërtetohet se paditësja nga data 18.04.2017 e deri më datën 30.04.2020 ka qenë i pranishëm në punë 709 ditë, Vërtetimi me nr. të prot.187/2021 i datës 11.06.2021 i lëshuar nga po shkollë me të cilën vërtetohet fakti se paditësja ka filluar punën në këtë shkollë nga data 2003 dhe vazhdon të punoj edhe më tutje, ka përvojë pune mbi 10 vite, Vërtetimi me nr. të prot.305/2020 i datës 14.12.2020 i lëshuar nga po kjo shkollë, përmes së cilës vërtetohet fakti se shkolla ku punon paditësja nuk ka kuzhinë funksionale për përgatitje të ushqimit, Kontratë pune në kohë të pa caktuar me nr. të prot.261 i datës 01.09.2015 përmes së cilës vërtetohet fakti se kjo kontratë është nënshkruar në mes të punëdhënësit dhe punëmarrëses K. H. në cilësi të punëtores teknike, Lista e pagave në emër të paditëses K. H. me nr.EM00057039, me të cilën vërtetohet se paga neto e paditëses është 268.30€, Formular për kërkesë apo ankesë e datë 24.06.2021 adresuar Komunës së Gjilanit, nga e cila vërtetohet se e njëjti fillimisht i është drejtuar të paditurës në procedurë administrative, por e njëjta ka heshtur”.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragraf 7 dhe 8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e lidhur me nenin 87 të Ligjit të Punës. Lidhur me kamatën ka vendosur konform nenit 382 të LMD-së derisa për shpenzimet e procedurës i është referuar dispozitave ligjore nga neni 452 të LPK-së. Po ashtu lidhur me vendosjen jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së sepse dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë edhe me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare, qoftë për themelësinë e kërkesëpadisë por edhe lartësinë e saj, ku në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar qartë mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse pjesa e ndryshuar e aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka paracaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për kompensimin e pagës jubilarë në atë mënyrë që përfundimi meritator është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar në një pjesë.

Po ashtu sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, ngase Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara, ngase sipas Vërtetimit me nr. protokolli 187/2021, të datës 11.06.2021 nuk ka qenë kontestuese se paditësja ka punuar tek e paditura si punëtore teknike e rregulltë që nga viti 2003 e tutje.

Mirëpo Gjykata e Apelit të Kosovës, vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 kur paditëses K. H. i ka njohur të drejtën për kompensimin e shpërblimit jubilar, me të cilën dispozitë shprehimisht parashihet se *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, për 10 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 50% të një page bazë, për 20 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 75 % të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe për 40 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 150 % të një page bazë”*. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që i rezultoi se në rastin konkret paditëses K. H., e drejta për të kërkuar kompensimin e pagës jubilarë nga e paditura i ka takuar në vitin 2013, e kjo sipas Vërtetimit me nr.187/2021, të datës 11.06.2021, lëshuar nga e paditura SHFMU “Selami Hallaçi” në Gjilan, nga i cili vërtetim rezulton se paditësja ka gjithsej 18 (tetëmbëdhjetë) vite përvojë pune, mirëpo në periudhën kur paditësja e ka mbushur jubileun, nuk ka pasur kontratë kolektive në fuqi, andaj nuk ka bazë ligjore për të kërkuar kompensim, pra në rastin konkret nuk është me rëndësi shumë periudha kur është kërkuar pasi çështje paraprake është se a ka pasur në fuqi kontratë kolektive në kohën e përmbushjes së kushtit për kompensim të pagës jubilarë. Meqenëse në vitin 2013 në kohën kur paditësja i ka mbushur vitet jubilarë, ka munguar baza ligjore, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata vendosi që të ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në rastin konkret edhe sikur të ekzistonte baza ligjore për të kërkuar kompensim, pra sikur të kishte qenë në fuqi kontrata kolektive në vitin 2013, vit kur paditësja e ka plotësuar kushtin pra përmbushja e jubileut, nga ajo kohë e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar më tepër se 3 vite sikurse përcaktohet me nenin 87 të Ligjit të Punës dhe padia e tillë është e paraqitur pas afatit ligjor. Prandaj, nga arsyet e theksuara gjykata ankimore duke vlerësuar se kërkesëpadija e paditësve për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, me referim në dispozitën e nenit 195, paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201, paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi që aktgjykimin në pjesën përkatëse ta ndryshoj me refuzimin e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit pasi që vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, me nxjerrjen dhe administrimin e provave shkresore dhe mbi bazën e fakteve jo kontestuese si dhe provave të administruara dhe me të drejtë ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses kur e ka obliguar të paditurën që në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të pranisë në punë t’ia kompensojë shumën përkatëse të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimin e ankimuar. Kjo pasi që nga gjendja faktike e vërtetuar edhe kjo gjykatë

me shikim në shkesa të lëndës vërteton se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën që nga viti 2003 dhe kjo në bazë të Vërtetimit me nr. protokoli 187/2021, të datës 11.06.2021 dhe sipas Kontratës së Punës me nr. protokoli 261, të datës 01.09.2015, konstatohet se paditësja është në marrëdhënie punë si punëtore teknike në SHFMU “S. H.” ne Gjilan, e po ashtu për periudhën kohore nga 18.04.2017 e deri më 30.04.2020 e njëjta ka gjithsej 709 ditë pune dhe kjo në bazë të Vërtetimit me nr.186/2021, të datës 11.06.2021.Po ashtu lartësia e pagës është përcaktuar konform edhe listës së pagës bashkangjitur shkresave të lëndës për të paditësen..

Prandaj në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar dispozitat ligjore të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përkatësisht nenin 35 paragrafi 7, të kësaj kontrate, në të cilin është paraparë se *“të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, 4 është 2 (dy) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”*.

Gjykata e Apelit vlerëson se pa dyshim kërkesëpadia e paditëses është pra pjesërisht e bazuar dhe se po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se *“ Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*.

Nga ana tjetër, pretendimi të cilin e ka theksuar e paditura në ankesë se nuk ka buxhet për këtë lloj kompensimi për punëmarrësit e saj sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron pasi që në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësit, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë. Këto situata, eventualisht të disfavorshme për të paditurën nuk mund ti rregulloj as gjykata e as paditësja, si punëmarrëse, e po ashtu kontratat e përgjithshme kolektive mund të parashohin më shumë të drejta për punëmarrësit, përtej ligjeve në fuqi, por në asnjë mënyrë nuk mund të jenë më të disfavorshme për punëdhënësit duke paraparë më pak të drejta se ato që parashihen me ligjet në fuqi.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj nga arsyet e theksuara gjykata ankimore vlerëson se kërkesëpadia e paditëses për shpërblim jubilar nuk ka bazë ligjore, e me referim në dispozitën e nenit 195, paragrafi 1 pika e), lidhur me nenin 201 paragrafi 1, pika d) të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.7997/2023, më datë 28.03.2024.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj